

Specifikacion

Produksion - Video Reklamuese

Numri I Prokurimit: 102/26

1. Qëllimi i Projektit

Qëllimi kryesor i projektit është promovimi i produkteve kreditore të FINCA Kosovë përmes një video reklame, që reflekton ndikimin pozitiv tek klientët dhe rrit shitjet përmes promovimit të produkteve kreditore.

2. Kërkesat e Përgjithshme

- Produksion i plotë profesional (koncept, skenar, xhirim dhe post-produksion)
- Video cilësore për përdorim në TV dhe platforma digjitale
- Respektimi i brand book të FINCA Kosovë
- Dorëzimi i materialeve finale në formatet e kërkuara (Full HD/4K)

3. Kompanite duhet të ofrojnë 2 koncepte si me poshte:

- **Koncepti 1: Storje Suksesi të Klientëve (Storytelling)**
 - Zhvillimi i 3 storjeve të shkurtra (deri në 15 sekonda secila)
 - Fokus në histori reale të klientëve të FINCA Kosovë (klientet propozohen nga FINCA Kosovë)
 - Të theksohet ndikimi i kredive në zhvillimin e biznesit apo përmirësimin e jetës
- **Koncepti 2: Koncept Kreativ për Promovimin e Kredive**
 - Zhvillimi i një koncepti origjinal (30–40 sekonda)
 - Fokus në promovimin e produkteve kreditore
 - Integrim i mundesise se aplikacionit mobil ne video si vlerë shtesë

4. Dorëzimi i Ofertave

Ofertat duhet të dorëzohen ndaras për secilin koncept dhe të përfshijnë:

- Propozimin kreativ (koncept/narrativë)
- Planin e realizimit
- Ofertën financiare të detajuar
- Afatet e realizimit
- Referenca të projekteve të ngjashme